



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Nr. 36 prot.

Kamëz, më 17. 03. 2023

V E N D I M

Nr 26 Datë 17/03/2023

P Ë R

**“DHËNIE NDIHME EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË NGA
BUXHETI I BASHKISË”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.03.2023, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.22, Datë 16.03.2023, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, ligji nr.57 dt. 18/07/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV, të Vendimit nr. 597 datë. 04/09/2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKB nr.163 dt 21.12.2022 “ Mbi detajimin e buxhetit per vitin 2023, 2024, 2025; VKB nr. 05 datë 23.01.2023 mbi Miratimin e kriterëve për trajtimin me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë për vitin, 2023”.

V E N D O S I :

1. Përdorimin e të ardhurave të bashkisë për ndihmë ekonomike me një fond prej 200.000 (dyqind mijë) lekë për muajin Mars 2023. Fondi do të përballohet sipas strukturës buxhetore Gr 0, prog., 10430, Kap.1, Art 606.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

2. Miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike për familjet si më poshtë.
- a) [REDACTED] me vlerën 100,000 lekë si një rast i veçantë për gjëndjen shëndetësore në të cilën ndodhet i biri.
- b) [REDACTED] me vlerën 100,000 lekë si një rast i veçantë për gjëndjen shëndetësore në të cilën ndodhet e bija.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Perfekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR-KËSHILLI

Hysen KOLDASHI